



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

DREJTORIA E EMIGRACIONIT DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE

SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE



Fushë-Arrëz, më 17.01 2025

Projekt-Propozim

Në mbështetje të ligjit Nr.57/2019, datë 18.07.2019. “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu IV, pika 2 e Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar, Udhëzimit Nr.5, datë 23.02.2018 “ Mbi miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6%.

Propozojmë:

Kriteret për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike prej 6%:

Të përfitojnë nga këto kriterë:

- 1.Të gjitha familjet të cilat nuk rezultojnë përfituese në skemen e Ndihmës Ekonomike për pikë të pamjaftueshme.
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
3. Familje me shumë fëmijë.

4. Familje me fëmijë jetimë.
5. Familjet me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë fëmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë antarë të paafte.
7. Familjet me kryefamiljare të veja apo të divorcuara.
8. Familje me dy ose më shumë antarë me vështirësi për t'u pranuar në tregun e punës.
9. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.
10. Shtohet kriteri për familjet me antarë me sëmundje kronike.
11. Shtohet kriteri që familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.

Propozim:

-Një herë në tre muaj familjet të bëhen pjesë e aplikimit në skemën e Ndihmës Ekonomike.

-Dokumentacioni i aplikuesve do të jetë në përputhje me VKM Nr.597, datë 04/09/2019 " Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike".

-Masa e Ndihmës Ekonomike të llogaritet sipas VKM Nr.597, datë 04/09/2019 " Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike".

Drejtoreshë e Emigracionit dhe e Çështjeve Sociale

Sidorela KATROSHI

Adresa: Fushë-Arrëz, Prefektura Shkodër, email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

DREJTORIA E EMIGRACIONIT DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE

SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE



Fushë-Arrëz, më 17.01.2025

Relacion

Në mbështetje të ligjit Nr.57/2019, datë 18.07.2019 “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu IV, pika 2 të Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr.5, datë 23.02.2018 “ Mbi miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6%.

Kriteret e vendosura janë të njëjta me kriteret e vitit paraardhës të cilat, do të paraqiten Këshillit Bashkiak në mbledhjen e muajit Janar për shqyrtim. I vetmi ndryshim është që VKM-ja nr.869 datë 18.06.2008 dhe zbatim i VKM-së nr.772 datë 13.12.2024 “Statusi i invalidit”, që ka të bëjë me marrjen e shtesës mujore të invalidit e cila paguhet nga ISSH së bashku me pensionin e invaliditetit apo të pleqërisë, në qendrat paguese tek “Posta Shqiptare”, apo në bankat e nivelit të dytë sipas kërkesës së përfituesit.

Drejtoreshë e Emigracionit dhe e Çështjeve Sociale

Sidorela KATROSHI

Adresa: Fushë-Arrëz, Perfektura Shkodër, email: info@bashkiafushearrez.gov.al